REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9-3/2019 regjistër (JR)
Datë 06.02.2023

Nr. 62 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	**Kryesuese**
Natasha Mulaj	**Relatore**
Sokol Çomo	**Anëtar**
Ina Rama	**Anëtare**
Rezarta Schuetz	**Anëtare**

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2026, ditën e martë, në orën 12:50, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen që i përket:

KËRKUESE: Entela Prifti, lindur më 13.08.1970 dhe banuese në rrugën "{***}", pallati {***}, Korçë, përfaqësuar[1] nga avokat Viktor Gumi, me nr. licence {***}.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, dhe neni 494 i Kodit të Procedurës Civile.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkueses në kërkesat e paraqitura prej saj, e cila përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes, Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

[1] *Me prokurën e posaçme nr. {***} rep. dhe nr. kol. {***}, datë 03.02.2023.*

VËREN:

1. Kërkuesja Entela Prifti (në vijim "kërkuesja"), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio,* sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016"). Fillimisht kaloi fazën e hetimit dhe shqyrtimit administrativ pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), i cili me vendimin nr. 69, datë 10.10.2018, vendosi: *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Entela Prifti, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë*. Ky vendim është ankuar nga subjekti i rivlerësimit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim "Kolegji").

2. Pasi ka shqyrtuar ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, vendosi: *lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Entela Prifti.*

3. Kërkuesja ka paraqitur në Kolegj katër kërkesa për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon.

3.1 Lidhur me kërkesën e parë, kërkuesja sjell në vëmendje se, më datë 04.10.2022, GjEDNj-ja ka dhënë vendimin për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, sipas të cilit ka vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në lidhje me të drejtën e kërkuesit (Besnik Cani) për një "gjykatë të krijuar me ligj". Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e drejta ndërkombëtare, që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare ka një vend të posaçëm. Neni 116 i Kushtetutës, që i rendit marrëveshjet ndërkombëtare pas Kushtetutës, u jep atyre fuqi mbi ligjin në sistemin e burimeve normative. Sa më sipër rezulton e qartë pozita e favorshme që kanë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 6/2006, ka përcaktuar se baza ligjore mbi të cilën ngrihet një kërkesë e tillë ka të bëjë drejtpërdrejt me konceptin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese është i rëndësishëm jo vetëm se sqaron vendin e KEDNJ-së në të drejtën e brendshme, por trajton në mënyrë shteruese edhe disa aspekte në lidhje me të.

3.2 Kërkuesja shpjegon se më i qartë është qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20/2011, kur kjo gjykatë nuk i është referuar Konventës si akt dhe pozicionit të saj në rendin e brendshëm juridik, po është ndalur më tepër në aspektin e efekteve juridike të vendimeve të GjEDNJ-së. Kërkuesja sqaron se vendimi i GJEDNJ-së i çështjes *Besnik Cani kundër Shqipërisë* ka marrë formë të prerë dhe është bërë përfundimtar në datën 04.01.2023 dhe brenda afatit 30-ditor paraqitet kjo kërkesë për rishikim vendimi gjyqësor të formës së prerë. Kërkesa për rishikim i paraqitet Kolegjit, sepse vendimi për kërkuesen është dhënë nga Kolegji që e ka shqyrtuar çështjen në themel, sipas së drejtës së brendshme.

3.3 Në rastin e kërkueses Entela Prifti, L. D. ka qenë anëtar i trupit gjykues që ka gjykuar çështjen e saj të rivlerësimit në Kolegj. Kërkuesja pretendon se është palë e interesuar dhe ka

interes të ligjshëm për të paraqitur kërkesën për rishikim, sipas nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, pasi është gjykuar dhe shkarkuar nga një gjyqtar i emëruar në detyrë në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo formë rishikimi çon në një përjashtim që lind për shkak të kërkesës për të respektuar detyrimet që burojnë nga e drejta ndërkombëtare. Në këtë kontekst, gjykata rishikuese, në rastin konkret Gjykata Kushtetuese, duhet të vlerësojë se si shkaqet e parregullsisë së procesit të mëparshëm të konstatuar nga GjEDNj-ja përkthehen në gabime të veprimeve procedurale, të parashikuara nga legjislacioni kombëtar dhe, për rrjedhojë, duhen marrë të gjitha masat e duhura që këto gabime apo parregullsi të mos ndodhin në procesin e ri gjyqësor.

3.4 Kërkuesja sqaron se në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, GJEDNJ-ja i është referuar parimeve të vendosura nga Dhoma e Madhe në gjykimin e çështjes *Ástráðsson kundër Islandës* dhe testit të tri fazave të përcaktuara në të. Islanda, në zbatim të këtij vendimi të Dhomës së Madhe, ka ndërmarrë rishikimin e të gjitha vendimeve gjyqësore, pjesë e të cilave ishte anëtari i trupit gjykues që ishte emëruar në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në funksionin e tij për të mbikëqyrur zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së në të drejtën e brendshme, konstatoi se rihapja e proceseve gjyqësore për ata individë që ishin gjykuar nga anëtarë të trupit gjykues, të emëruar në kundërshtim me nenin 6 të Konventës, sipas vendimit të Dhomës së Madhe të sipërcituar, përbënte zbatim të plotë të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kërkuesja, nëpërmjet kërkesës për rishikim, pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 494, germa "ë" e Kodit të Procedurës Civile.

3.5 Në përfundim, znj. Entela Prifti kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019. Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin të vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesja ka paraqitur si në vijim*:* (i) Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019. (ii) Material në gjuhën angleze (6 faqe), i Përfaqësuesve të Përhershëm të Islandës në Këshillin e Evropës drejtuar Departamentit për Ekzekutimin e Gjykimeve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

3.6 Në kërkesën e dytë, nr. 203/54, të datës 24.05.2023, kërkuesja, nëpërmjet kësaj kërkesë, ka kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019. Ajo pretendon se, gjatë përgatitjes së dokumentacionit për shqyrtimin e kërkesave për rishikim, që ka paraqitur në Kolegj, ka kërkuar pranë Komisionit një kopje të dosjes që i përket procesit të saj të rivlerësimit. Me shqyrtimin e materialeve të dosjes së Komisionit, kërkuesja ka konstatuar si pjesë të akteve të saj, analizën ekonomike financiare të Komisionit, akt i cili pretendon se nuk i është vënë në dispozicion gjatë gjithë procesit të saj të rivlerësimit në Komision e Kolegj dhe as është referuar në asnjë prej vendimeve për shkarkimin e saj, dhe përmban të dhëna në lidhje me vlerësimin e pasurisë së kërkueses, të ndryshme nga ato të pranuara nga Komisioni në vendim.

3.7 Akti i cituar më sipër, i ndodhur në dosjen e rivlerësimit dhe administruar në të, pas dhënies së vendimit të Komisionit, referuar numërtimit të fletëve të tij dhe administrimit të akteve të marra gjatë procesit administrativ, përbën një shkak të ri për rishikimin e vendimit dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, duke qenë se nga leximi i tij rezulton një situatë tjetër financiare nga

ajo e pranuar në vendim dhe që, nëse do të ishte vlerësuar në kuadër të hetimit të kryer, mund të sillte një tjetër rezultat vlerësimi për subjektin. Për sa më lart, kërkuesja pretendon se plotësohen kërkesat e ligjit*:* (i) pala ka marrë dijeni për një provë të re, për të cilën nuk është njoftuar dhe njohur gjatë procesit të rivlerësimit, neni 494, germa "a" e Kodit të Procedurës Civile; (ii) kërkesa për rishikim paraqitet brenda afatit 30-ditor të përcaktuar në nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile.

3.8 Kërkuesja kërkoi nga Kolegji pranimin e kërkesës për rishikim dhe rishikimin e vendimit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.
Bashkëngjitur kërkesës ka paraqitur aktet si në vijim: (i) Analizë ekonomike, e hartuar në Komision, për subjektin e rivlerësimit Entela Prifti; (ii) Vendimin nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; (iii) Vendimin nr. 34, datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; (iv) Shkresë e Komisionit me lëndë "kthim përgjigje", me nr. prot {***}, datë 14.04.2023; (v) Inventar i Komisionit për aktet e dosjes së subjektit të rivlerësimit E. Prifti.

3.9 Sipas kërkesës së tretë, me nr. 1290, datë 20.12.2024, kërkuesja ka kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019. Ajo shpjegon se, nga burime mediatike dhe duke lexuar faqen zyrtare *online* të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është vënë në dijeni të dënimit penal të gjyqtarit relator të çështjes së saj të rivlerësimit, në Kolegj, z. A. H., i cili, me vendim të formës së prerë, datë 18.11.2024, është gjetur fajtor për akuzën penale të ngritur ndaj tij. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 494 dhe 495 të Kodit të Procedurës Civile, kërkuesja sqaron se dënimi penal i të pandehurit A. H., legjitimon kërkuesen për të kërkuar rishikimin e vendimit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, të Kolegjit. Në këto rrethana, ajo pretendon se ka shkaqe ligjore për rishikimin e vendimit të cituar më sipër dhe kërkon nga Kolegji pranimin e kësaj kërkese sipas objektit të saj. Këtë kërkesë znj. Prifti e mbështet në nenin 494, germa "c" e Kodit të Procedurës Civile.

3.10 Në kërkesën e saj të katërt, nr. {***} prot, datë 20.04.2023, kërkuesja pretendon se për anëtarin e trupit gjykues të Kolegjit, që ka gjykuar çështjen e saj të rivlerësimit, gjyqtari L. D., Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, ka vendosur deklarimin fajtor të tij, për kryerjen e veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3.11 Me vendimin nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga L. D., kundër vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Lartë, më datë 21.03.2023, në dhomë këshillimi, ka marrë në shqyrtim çështjen penale me kërkues L. D., me objekt*: "Shfuqizimin e vendimeve nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2021-670 (63), datë 26.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së*

Lartë si të papajtueshëm me Kushtetutën [...]", dhe me vendimin nr. 00-2023-471 (76) ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 08.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar".* Kërkuesja sqaron se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shpallur publikisht, në datën 21.03.2023, vetëm dispozitivin e vendimit të tij, ndërsa arsyetimi nuk ishte bërë publik në këtë datë. Këtë kërkesë, znj. Prifti e mbështet në nenin 494, germa "c" e Kodit të Procedurës Civile.

3.12 Sa më sipër, kërkuesja pretendon se plotësohen të gjitha kushtet për të bërë të mundur rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 34, datë 02.12.2019, për shkak se në përbërjen e trupit gjykues ka qenë një gjyqtar i ndëshkuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë, për veprën penale "falsifikim dokumentesh", gjë e cila përbën njëkohësisht edhe shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në komponentin "gjykatë e krijuar me ligj". Bashkëlidhur kërkesës për rishikim, kërkuesja Entela Prifti ka dorëzuar vendimin nr. {***}, datë 01.12.2020, të Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Në seancën gjyqësore, të datës 24.03.2026, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nenin 448 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 19, pika 1/1 e rregullores "Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese", vendosi të bashkojë për gjykim me çështjen nr. 9-3/2019 (JR), datë 06.02.2023, edhe kërkesat me nr. 203/54 prot., datë 24.05.2023, dhe me nr. 1290 prot., datë 20.12.2024, si dhe çështjen me nr. 50-3/2019 (JR), datë 20.04.2023, të kërkueses Entela Prifti, me objekt: *rishikimin e vendimit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*.

I. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegj

Juridiksioni i Kolegjit

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 e Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit Ë, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu sipas pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

6. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit, nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi dhe, *së dyti,* as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit

kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.

7. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi, sikurse në vendimin e tij të mëparshëm, me nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson, edhe në këtë rast, në mënyrë të përmbledhur, atë qëndrim për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve, trupi gjykues vëren se në to parashikohet në mënyrë të shprehur vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit, në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga Komisionerët Publikë. Trupi gjykues ka theksuar se, nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesave të parashtruara prej kërkueses, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.

8. Trupi gjykues i Kolegjit në vendimin e referuar më sipër ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues, si një prej tagrave të tij, dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa "ë" e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Sikurse analizuar në detaj, në vendimin e sipërcituar të Kolegjit, është analizuar përse procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuesja.

9. Nga leximi harmonik i dispozitës së nenit F, pika 8[2] e Aneksit të Kushtetutës dhe germës "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile[3], një vendim i GjEDNj-së që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre, dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim i drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar gjatë procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe

[2] *Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

[3] *"[...] Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës evropiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.*

Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive.

10. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkueses. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm, zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezulton edhe nga mënyra se si është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, lexuar në harmoni me pikën 8 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës.

11. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në gjashtë germat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se, jo pa qëllim, kushtetutbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa "ë" të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.

12. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesave të paraqitura prej kërkueses, Entela Prifti, për të cilën GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Këto kërkesa nuk mund të shqyrtohen nga Kolegji, për shkak të mospasjes të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuesja bën në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës[4] së Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkueses, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa "ë" të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.

13. Në përfundim, kërkesat e paraqitura prej kërkueses Entela Prifti nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germa "ë" e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, këto kërkesa konsiderohen nga trupi gjykues si të papranueshme. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative, të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili

[4] *Vendimi nr. 12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuesit A. Y.; Vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit A. B.; Vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuesit B. M.*

është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.

14. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkueses nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsyetimit të mësipërm, sërish ato, edhe si *obiter dictum*, do të vlerësoheshin njësoj si të pabazuara edhe nëse do t'i nënshtroheshin shqyrtimit gjyqësor në Kolegj. Së fundmi, dhe po aq më rëndësi, sikurse GjEDNj-ja ka theksuar, konstatimi i shkeljes së të drejtës për një *gjykatë të krijuar me ligj*, në rastin e çështjes së ngritur nga B. Cani dhe referuar më parë edhe në çështjen e *Ástráðsson kundër Islandës*, nuk mund të konsiderohet vetvetiu një detyrim sipas Konventës, për t'i imponuar një shteti të paditur të rihapë të gjitha çështjet e ngjashme që janë bërë *res judicata* sipas ligjit të brendshëm, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se nuk gjen zbatim germa "ë" e nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

15. Sa i përket ndikimit të veprës penale për të cilën është deklaruar fajtor ish-gjyqtari L. D., trupi gjykues vlerëson se mungon lidhja shkakësore, mes veprimeve të kryera në kuadër të dënimit penal dhe ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në procesin e rivlerësimit të kërkueses. Për më tepër, edhe duke abstraguar nga mungesa e lidhjes shkakësore që nevojitet për zbatimin e germës "c", të nenit 494, të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet që vepra penale referohet të jetë kryer vite përpara vendimit për të cilin kërkohet rishikimi, neni 494, germa "c" e Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të argumentohet se gjen zbatim, elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit në çështje të tjera[5]. Lidhur me anëtarin tjetër të trupit gjykues, A. H., përveçse nuk ka ende një vendim përfundimtar për çështjen penale mbi të cilën kërkuesja ka mbështetur kërkesën e tretë për rishikim, veprat penale për të cilat akuzohet gjyqtari A. H., nuk kanë asnjë lidhje shkakësore me vendimin për të cilin kërkohet rishikimi, pasi ato kanë ndodhur para se ai të zgjidhej gjyqtar në Kolegj. Sa i përket analizës financiare për të cilën kërkuesja pretendon se e ka gjetur në dosjen e Komisionit dhe me të cilën nuk ishte njohur më parë, trupi gjykues vlerëson se ky akt, duke qenë se ka ekzistuar në kohën e dhënies së vendimit, pasi ndodhet i inventarizuar në dosjen e Komisionit, prezumohet se ka qenë në dijeni të Komisionit dhe Kolegjit para marrjes së vendimeve përkatëse. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se ky dokument nuk mund të konsiderohet si një provë e re në kuptim të germës "a", të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

16. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesat e paraqitura prej kërkueses Entela Prifti nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës e nenit 494, germat *"a", "c", "ë"* të Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ato konsiderohen të papranueshme.

[5] *Vendimet e Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023 dhe nr. 4, datë 15.02.2024.*

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile, shumicë votash,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesave të kërkueses Entela Prifti, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 34, datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me: (i) nr. 9-3/2019 (JR), datë 06.02.2023; (ii) nr. 203/54 prot., datë 24.05.2023; (iii) nr. 1290 prot., datë 20.12.2024; (iv) nr. 50-3/2019 (JR), datë 20.04.2023.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTAR	**ANËTARE**	**ANËTARE**
Sokol ÇOMO	**Ina RAMA**	**Rezarta SCHUETZ**
nënshkrimi	*nënshkrimi*	*nënshkrimi*

RELATORE	**KRYESUESE**
Natasha MULAJ	**Albana SHTYLLA**
nënshkrimi	*nënshkrimi – kundër*

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam dakord me vendimin nr. 62 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *"Mospranimin e kërkesave të kërkueses Entela Prifti, për rishikimin e vendimit nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me: (i) nr. 9-3/2019 (JR), datë 06.02.2023; (ii) nr. 203/54 prot., datë 24.05.2023; (iii) nr. 1290 prot., datë 20.12.2024; (iv) nr. 50-3/2019 (JR), datë 20.04.2023"*, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuesja.

2. Në cilësinë e gjyqtares me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *"[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa "ë" e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkueses, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa "ë" të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së"*.

3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja "ë" e kësaj dispozite: *"Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane 'Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore' dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë"*.

4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesa e rishikimit ndaj vendimeve të tij nuk mund të pranohet. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, në çështjen që i përket kërkesës së znj. Entela Prifti, për rishikimin e vendimit të formës së prerë nr. 34 (JR), datë 02.12.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pra, për pranimin e saj për sa parashtruar në vijim.

2. Shumica e trupit gjykues në përfundim ka konkluduar se *Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuesit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa "ë" të Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm, i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.*

3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" [në vijim "ligji nr. 84/2016"] dhe legjislacionit në fuqi, në këtë çështje kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile[6], ndaj duhet të kishte pranuar këtë kërkesë dhe, për rrjedhojë, të kishte hapur shqyrtimin gjyqësor lidhur me të. Ky qëndrim bazohet në argumentet si vijojnë.

4. Referuar përcaktimit të nenit F, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji i Posaçëm i Apelimit [në vijim "Kolegji"] është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit [në vijim "Komisioni"] dhe zgjidh çështjen përfundimisht në sistemin e brendshëm gjyqësor.

4.1 Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, sistemi i rivlerësimit u ngrit me qëllim garantimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te ky sistem. Ligjvënësi në nenin 179/b të Kushtetutës, si dhe në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar se procesi i rivlerësimit kalimtar kryhet në përputhje me parimet e procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit. Kolegji si gjykata e vetme e procesit të rivlerësimit shqyrton dhe konkludon në vlerësim të shkaqeve të ankimit, si gjykatë fakti bazuar në provat dhe ligjin e zbatueshëm, por edhe si një gjykatë që gjatë shqyrtimit të ankimit garanton të drejtat dhe liritë themelore, si dhe një proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit.

---

[6] *Të njëjtin qëndrim kam mbajtur dhe për kërkesën e z. A. Y., për rishikimin e vendimit nr. 31 (JR), datë 20.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.*

Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: *" […] Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën"*[7].

4.2 Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se ligjvënësi nëpërmjet përcaktimeve në dispozitat kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016 ka konfiguruar një gjykatë e cila zbaton të gjitha garancitë procedurale të një gjykate fakti, duke përthithur në të njëjtin gjykim dhe shqyrtimin e çdo pretendimi që do të paraqitej në kuadër të një ankimi kushtetues individual. Përcaktimi i mësipërm kushtetues dhe ligjor dëshmon për një vullnet të ligjvënësit për garantimin e parashikimeve të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe detyrimeve që burojnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në vijim KEDNj].

Në konsideratë të sa më sipër, kam vlerësuar se Kolegji, si gjykata e vetme e procesit, nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, garanton gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit, përfshirë dhe të drejtën për akses në gjykatë, sipas nenit 6/1 të KEDNj-së. Ashtu siç edhe ka theksuar Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [në vijim GjEDNj], e drejta për akses në gjykatë duhet të jetë *"konkrete dhe efektive"*, ndërkohë që efektshmëria e së drejtës për akses kërkon që një individ të *"gëzojë mundësinë e qartë dhe konkrete për të kundërshtuar një ndërhyrje në të drejtat e tij"*[8]. Në zbatim të jurisprudencës së GjEDNj-së e drejta për të ankimuar një ndërhyrje në të drejtat e një individi, si dhe zgjidhja e çështjes në gjykatë garantohet, ndër të tjera, edhe nëpërmjet njohjes së të drejtës për mjete efektive të ankimit, qofshin ato të zakonshme apo edhe të jashtëzakonshme.

4.3. Neni 43 i Kushtetutës garanton të drejtën e ankimit, si një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale të legjislacionit në fuqi. Kushtetuta garanton të drejtën e ankimit, duke mbajtur parasysh si sigurinë juridike edhe parashikueshmërinë e sistemit juridik, me qëllim që palëve t'u sigurohet ankim efektiv, për çdo cenim të drejte/interesi të ligjshëm, si dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes. Sa i përket parimit të parashikueshmërisë dhe qartësisë së sistemit të së drejtës për të shfrytëzuar mjetet e ankimit, çdo individ duhet të ketë mundësinë dhe qartësinë për mjetet e mundshme të ankimit dhe kushtet që duhet të plotësojë për ushtrimin e tyre në interes të tij.

5. Në vijim të sa më sipër, në ndryshim nga shumica, vlerësoj se në një analizë harmonike të nenit A dhe nenit F, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, me parashikimet e neneve 4 paragrafi 6, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016, subjekteve të rivlerësimit u njihet e drejta për akses në gjykatë bazuar në legjislacionin në fuqi, jo vetëm për të ankimuar vendimet e Komisionit pranë Kolegjit, por edhe për të ushtruar rishikimin si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ndaj një vendimi të gabuar të Kolegjit dhe për një zgjidhje të drejtë të çështjes së tyre. Për rrjedhojë, kam vlerësuar se Kolegji ka juridiksion rishikues dhe kompetencë për të kontrolluar vendimin e tij, bazuar në rrethanat e përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile.

[7] *Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafi 68.*
[8] *Bellet kundër Francës, paragrafët 36 dhe 38, Nunes Dias kundër Portugalisë (déc.).*

5.1. Ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar se*: "Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi "f", 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi "b", kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës".* Në përcaktimet e nenit A të Aneksit të Kushtetutës, ligjvënësi ka pasur në konsideratë se kufizimi apo ndalimi i një të drejte themelore apo një garancie procedurale të mbrojtur nga Kushtetuta dhe KEDNj-ja, duhet të bëhet me ligj, bazuar në nenin 17 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të parimit të sigurisë juridike, por dhe të parashikueshmërisë për mjetet efektive.

Nga parashikimi i mësipërm i Aneksit të Kushtetutës nuk evidentohet që ligjvënësi të ketë kufizuar apo ndaluar në mënyrë eksplicite rishikimin si një mjet efektiv i jashtëzakonshëm i ankimit, ashtu siç ka bërë për të drejta të tjera, si ajo e parashikuar në nenin 131, nënparagrafi "f" për ankimin kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Krejt ndryshe duket se ka vepruar ligjvënësi lidhur me institutin e *"barrës së provës"*, për të cilin jo vetëm ka parashikuar kufizimin në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, por edhe ka detajuar në nenin Ç, pika 5 të tij, që në këtë proces barrën e provës e ka subjekti i rivlerësimit dhe, më tej, në nenin 52, paragrafi 3 të ligjit nr. 84/2016, ka përjashtuar në mënyrë eksplicite zbatimin e nenit 82 të Kodit të Procedurës Administrative. Këto parashikime për institutin e "*barrës së provës"* dëshmojnë se nëse ligjvënësi kishte për qëllim të ndalonte të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një mjet efektiv të jashtëzakonshëm ankimi, siç është rishikimi i vendimit, ai ka qenë i qartë për mënyrën si duhet të normohej ndalimi apo kufizimi i një të drejte apo garancie procedurale në kuadër të procesit të rivlerësimit.

5.2. Gjithashtu, rezulton se kufizimi apo ndalimi për rishikimin e vendimit si një mjet efektiv ankimi nuk është parashikuar edhe në asnjë dispozitë të ligjit nr. 84/2016. Ligjvënësi në nenet 62, 63, 64 e 65 të ligjit nr. 84/2016, ka rregulluar në mënyrë të posaçme vetëm mjetin e zakonshëm të ankimit, duke përcaktuar në përmbajtjen e këtyre dispozitave subjektet procedurale që mund të ushtrojnë këtë të drejtë, organin pranë të cilit depozitohet ankimi, afatet në të cilat ushtrohet kjo e drejtë, procedurën e njoftimit të ankimit etj. Mosparashikimi në mënyrë eksplicite në ligjin nr. 84/2016 i të drejtës për rishikimin e vendimit të Kolegjit, nuk duket se ka pasur për qëllim kufizimin apo ndalimin e kësaj të drejte për subjektet e rivlerësimit, përkundrazi kam vlerësuar se mungesa e një rregullimi të posaçëm kufizues apo ndalues lejon mundësinë e ushtrimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi.

Ky qëndrim bazohet dhe në argumentin që ligjvënësi në ligjin nr. 84/2016 duket se nuk ka ndjekur një model të një ligji me parashikime shteruese të gjithë të drejtave dhe garancive procedurale të subjekteve të rivlerësimit. Për këtë arsye, neni 4 paragrafi 6 i po këtij ligji ka parashikuar se: *"Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji".* Në referim të përcaktimeve të nenit 4, paragrafi 6 i ligjit nr. 84/2016, nenit 1, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i

ndryshuar [në vijim "ligji nr. 49/2012"] dhe nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, ligjvënësi ka njohur garancinë procedurale të ushtrimit të rishikimit të vendimit si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi.

5.3. Sa i përket kompetencës lëndore të Kolegjit për rishikimin e vendimit, kam vlerësuar se ajo është e rrjedhur nga fakti që Kolegji është gjykata që ka shqyrtuar në themel ankimin ndaj vendimit të Komisionit. Referuar nenit 497, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Civile *Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta,* ***kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel.*** *Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykimi.*

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017 ka parashikuar se: *[…] Në nenin 43 të Kushtetutës parashikohet se: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës". […] Ajo duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. […]* ***Gjykata vlerëson se nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në ligjin për rivlerësimin kalimtar, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ai mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe se të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera*** *(shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias)"* [9].

Pra, Gjykata Kushtetuese, në interpretimin e saj pajtues për ligjin nr. 84/2016, ka theksuar që pavarësisht se Kolegji është një gjykatë me juridiksion të posaçëm, ai u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vlerësimit, bazuar në një skemë të gjerë legjislative dhe kushtetuese, duke nënkuptuar dhe pranuar në interpretim harmonik me përcaktimet e nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, që brenda kësaj skeme legjislative nuk është vetëm Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, por dhe legjislacioni procedural përkatës, si ligji nr. 49/2012 apo Kodi i Procedurës Civile[10].

5.4. Ndryshe nga shumica, e cila konsideron parashikimin e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës si dispozitën që kufizon ushtrimin e të drejtës së rishikimit të vendimit, vetëm në rastin/rrethanën e përcaktuar në nenin 494, germa "ë" të Kodit të Procedurës Civile, kam

---

[9] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafët 65 dhe 66.
Qëndrimi i Komisionit të Venecias, i referuar nga Gjykata Kushtetuese në këtë vendim është si vijon: "Për sa i përket pyetjes nëse mungesa e mundësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetting-ut, për të kundërshtuar vendimet e marra nga institucionet e rivlerësimit para gjykatave kombëtare, përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, Komisioni i Venecias konsideron se përgjigjja e kësaj pyetje varet nga mënyra e cilësimit të Kolegjit të Apelimit në Kushtetutë dhe në Ligjin e Vetting-ut. ***Për Komisionin e Venecias, këto tekste ligjore parashikojnë elemente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se Kolegji i Apelimit mund të konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili i jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e vetting-ut. Të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legjislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera".***
[10] Nëse referuar nenit 4, pika 6 dhe nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikime të posaçme.

vlerësuar se qëllimi*/ratio legis* i këtij parashikimi nuk ka qenë kufizimi i rrethanave të rishikimit të vendimit të Kolegjit vetëm në rastet kur GjEDNj-ja ka marrë një vendim për kërkesën e paraqitur nga vetë subjekti.

5.4.1. Siç kam referuar më sipër në këtë mendim, ligjvënësi në nenin A të Aneksit të Kushtetutës, me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, subjekteve të rivlerësimit i ka kufizuar të drejtën sipas nenit 131, paragrafi "f" të Kushtetutës, pra, të drejtën për ankim kushtetues individual pranë Gjykatës Kushtetuese. Në vlerësimin tim, parashikimi i nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, ka pasur për qëllim të definojë dhe qartësojë në mënyrë të shprehur se ndryshe nga kontrolli kushtetues i realizuar në Gjykatën Kushtetuese me ankime individuale ndaj vendimeve përfundimtare të sistemit të brendshëm gjyqësor, në juridiksionin e rivlerësimit Kolegji është gjykata e cila përthith dhe shqyrtimin e çështjeve, të cilat mund të ngrihen nëpërmjet një ankimi kushtetues individual, ndaj vendimi i tij nuk mund të ankimohet në Gjykatën Kushtetuese, por në GjEDNj.

5.4.2. Duket se në të njëjtën mënyrë ka thirrur në interpretim pajtues përcaktimet e nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas së cilit: *"Në lidhje me të drejtën për ankim kushtetues individual, në vlerësimin e Komisionit të Venecias Kushtetuta ka heshtur në lidhje me faktin nëse një subjekt mund të paraqesë një ankim individual para Gjykatës Kushtetuese dhe se në mungesë të një ndalimi nuk ka arsye për të përjashtuar një mundësi të tillë (paragrafi 44 i opinionit CDL-AD (2016)036). Në vlerësimin e Gjykatës, Kushtetuta nuk ka heshtur në lidhje me këtë drejtë, ashtu si edhe për disa të drejta të tjera kushtetuese. Gjykata vëren se, sipas nenit A të Aneksit të Kushtetutës me qëllim kryerjen e këtij procesi kufizohet edhe nënparagrafi "f" i nenit 131 të Kushtetutës, çka nënkupton se ky kufizim lidhet specifikisht me të drejtën e subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi për t`iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kurse sipas nenit F, pika 8, po të Aneksit, subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në GJEDNJ. Vlerësimi nëse ky kufizim është proporcional apo jo nuk mund të jetë objekt i këtij gjykimi për sa kohë që ai jo vetëm është vendosur në rang kushtetues, por edhe sepse Gjykata nuk ka juridiksion për vlerësimin në themel të këtyre dispozitave, të cilat janë inkorporuar në Kushtetutë me anë të një ligji rishikues. Megjithatë, duke pasur parasysh kompetencat e KA-së si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, vlerësohet se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën"*[11].

5.4.3. Nga ana tjetër, në vlerësimin tim, nëpërmjet këtij përcaktimi të nenit F, pika 8 të Aneksit të Kushtetutës, gjen pasqyrim detyrimi i KEDNj-së, sipas së cilit çdo individ mund të paraqesë një ankim në GjEDNj, nëse pretendon se ka pasur cenim të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë akt ndërkombëtar të Këshillit të Evropës.

6. Bazuar në sa më sipër, në një interpretim harmonik të përcaktimeve të nenit F, pikat 1 dhe 8 të Aneksit të Kushtetutës[12], nenit 4, paragrafi 6 të ligjit nr. 84/2016, të referuar në paragrafin 5.2 më sipër, si dhe nenit 1, paragrafi 2 i ligjit nr. 49/2012, në konsideratë edhe të mungesës së

[11] Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, paragrafi 68.

[12] Kolegji si organi i rivlerësimit, që shqyrton në themel ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, përthith juridiksionin dhe kompetencën rishikuese.

parashikimeve eksplicite për kufizim të të drejtës së rishikimit vetëm në rrethanën e përcaktuar në germën "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësoj se Kolegji ka juridiksion rishikues për të gjitha rrethanat e përcaktuara në këtë dispozitë[13].

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë* në paragrafin 46 të të cilit ka vlerësuar se: *Në mbështetje të nenit 4(6) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 1(2) të ligjit për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative") organet e rivlerësimit, në rrethana të caktuara, mund të zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, i cili është i formës së prerë në rrethana të caktuara, më konkretisht kur […][14]".* Në këtë paragraf, GjEDNj-ja rendit të gjitha rrethanat e përcaktuara nga germa "a" në germën "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke mos e kufizuar ushtrimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm ankimi vetëm në rrethanën e përcaktuar në germën "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu, GjEDNj-ja, në po këtë vendim në paragrafin 111, ka theksuar se: *Kërkuesja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L. D., për pozicionin e tij,* ***një kërkesë për rishikim përjashtimor në vendimin e formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi, apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 46 më sipër) […]***.

7. Bazuar në sa më sipër analizuar, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues, si dhe është gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj kërkese.

8. Sa i përket shkaqeve të paraqitura në dy prej kërkesat e znj. Entela Prifti, në të cilat është kërkuar rishikimi i vendimit të Kolegjit për shkak të dënimit penal të gjyqtarëve L. D. dhe A. H., kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, e duke vendosur mospranimin e tyre.

9. Lidhur me shkakun e paraqitur ne kërkesën e dytë, nr. {***}, të datës 24.05.2023, sipas të cilit kërkuesja ka pretenduar se në materialet e dosjes së Komisionit ka konstatuar si pjesë të akteve të saj, një analizë ekonomike financiare të Komisionit e cila nuk i është vënë në dispozicion gjatë gjithë procesit të saj të rivlerësimit në Komision dhe as është referuar në asnjë prej vendimeve për shkarkimin e saj, analizë e cila përmban të dhëna të ndryshme në lidhje me vlerësimin e pasurisë së saj, nga ato të pranuara nga Komisioni në vendim, kam ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues.

10. Lidhur me këtë shkak rishikimi, nga analiza e akteve të përcjella nga kërkuesja bashkëlidhur kërkesës për rishikim, akteve të administruara në Kolegj, si dhe akteve të konsultuara nga burime të hapura konstatoj si vijon.

---

[13] Qëndrim ky i mbajtur nga Kolegji dhe për kërkesat për rishikim vendimi të kërkueseve R. G. dhe A. G..
[14] GjEDNj-ja rendit të gjitha rrethanat e përcaktuara nga germa "a" në germën "ë" të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.

10.1 Akti i paraqitur bashkëngjitur kërkesës për rishikim të znj.Entela Prifti titullohet "Analizë ekonomike financiare e dosjes për rivlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Entela V. Prifti". Në këtë akt prej 7 fletësh/15 faqesh [të printuara në të dy anët], rezulton se ka një numërtim të çdo flete në rend rritës[15], që duket se ka ndjekur numërtimin e faqeve pararendëse të dosjes së administruar gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision. Akti në çdo fletë të tij ka vulën "Komisioni i Pavarur i Kualifikimit/Vërtetohet Njësia me Origjinalin".
Nga përmbajtja e kësaj analize ekonomiko-financiare të përgatitur nga Komisioni, rezulton se subjekti për periudhën 2003-2016, ka një mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vite, në total në vlerën rreth -820,000 lekë.

10.2 Vendimi i Komisionit[16], në përmbajtjen e tij nuk ka asnjë analizë ekonomike financiare për periudhën 2003-2016, por ka konkluzione për mungesë burimesh financiare të ligjshme [pa vlera konkrete të këtyre mungesave] sipas nenit 33, pika 5, gërma "b" të ligjit nr.84/2016, për pasuritë objekt verifikimi të krijuara gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, konstatoj se në arsyetimin e vendimit të Komisionit, nuk pasqyrohet metodologjia që është zbatuar për përllogaritjen e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit/kërkueses për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në këto vite, pra nëse kjo mundësi është llogaritur në bazë analize vjetore apo me momentin e krijimit të pasurisë/kryerjes së shpenzimit përkatës. Nga vendimi i Komisionit, nuk rezulton që subjektit të rivlerësimit/kërkueses Entela Prifti me rezultatet e hetimit paraprak t'i jetë përcjellë një analizë ekonomiko-financiare për periudhën 2003-2016 me metodologjinë e zbatuar për kryerjen e saj, apo t'i ketë kaluar barrë prove për mungesë burimesh financiare të ligjshme, me vlera konkrete për pasuritë objekt verifikimi, shpenzime të kryera, apo për vitet në periudhën 2003-2016.

10.3 Vendimi Kolegjit[17], ashtu si edhe vendimi i Komisionit, ka ndjekur të njëjtën mënyrë analize dhe arsyetimi duke mos përfshirë në përmbajtjen e tij asnjë analizë ekonomiko-financiare për periudhën 2003-2016, por ka konkluzione për mungesë burimesh financiare të ligjshme [pa vlera konkrete të mungesave dhe pa referuar metodologjinë që është zbatuar për këto konkluzione] sipas nenit 33, pika 5, gërma "b" të ligjit nr.84/2016, për pasuritë objekt verifikimi të krijuara gjatë kësaj periudhe.

10.4 Në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkese për rishikim, Kolegji nuk kishte të administruar në arkivën e tij, dosjen e krijuar dhe administruar gjatë hetimit në Komision për çështjen e subjektit të rivlerësimit Entela Prifti. Kjo dosje, pas marrjes së Vendimit nr. 34 (JR), datë 02.12.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili në përfundim të mandatit të tij duhet t'a ketë përcjellë për t'u arkivuar në një institucion tjetër.

Gjendur në këto kushte, me qëllim shqyrtimin e pretendimit të kërkueses, se kjo analizë financiare përbën një provë të re me ndikim në zgjidhjen e çështjes, sipas nenit 494, germa "a" e Kodit të Procedurës Civile, si dhe për arsye se nuk kam qenë gjyqtare, pjesë e trupit gjykues

---

[15] Fillon me numrin 5550 deri ne numrin 5557
[16] http://magjistrat.al/dokumenta/17097994371594372968Vendim-Entela-Prifti.pdf
[17] https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendimi-SR-Entela-Prifti-i-anonimizuar-perfshire-mendimin-paralel.pdf

që ka shqyrtuar çështjen e saj në Kolegj, pra nuk kam pasur dijeni për shkak të vendimmarrjeve të mëparshme mbi aktet e administruara në këtë dosje, kam çmuar që për një vlerësim të plotë dhe të drejtë të saj, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm të administronte dosjen e hetimit administrativ të administruar nga Komisioni.

11. Lidhur me shqyrtimin e kërkesës, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, konkretisht neneve 4, pika 6 dhe 65, pika1, vendimmarrjet e Kolegjit, në kuadër të kompetencave të tij, i nënshtrohen rregullave të legjislacionit procedural mbi gjykimin e ankimit në gjykatën e apelit administrativ, ndaj dhe për këtë kërkesë duhet të zbatoheshin, për aq sa është e mundur dhe e lejuar, rregullat dhe procedurat që kanë gjetur zbatim në dhënien e vendimi objekt rishikimi. Në konsideratë të këtij qëndrimi, në çështjen në fjalë, duhet të gjente zbatim parashikimi i nenit 498 i Kodit të Procedurës Civile, për sa ai referon në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për rishikim nga gjykata e apelit.

Në shqyrtimin të kritereve të pranueshmërisë së kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit 34 (JR), datë 02.12.2019, në referim të përcaktimeve të pikës 1 të nenit 498 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohen të papranueshme rastet të cilat janë jashtë përcaktimeve të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile apo kur ajo është haptazi e pambështetur.

12. Në konsideratë të sa më sipër, pas shqyrtimit të përmbajtjes së kërkesës së znj.Entela Prifti dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, kam vlerësuar se kjo kërkesë referonte rrethana të cilat ishin brenda parashikimeve të nenit 494, germa "a", sipas së cilës një kërkesë për rishikim mund të paraqitet nëse *zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj.*
Në ndryshim nga shumica e cila këtë akt e ka konsideruar si një akt që ka ekzistuar në dosjen e Komisionit në kohën e dhënies së vendimit, pasi ndodhet i inventarizuar në dosjen e tij[18], duke prezumuar se kërkuesja është njohur, si dhe ka qenë një akt në dijeni të Komisionit dhe Kolegjit, kam vlerësuar se listimi i një akti në inventarin e një dosje, në pamundësi për të verifikuar vetë aktin, nuk provon *a priori* se ai ka ekzistuar në dosje. Pra, ndyshe nga shumica kam vlerësuar se vetëm emërtimi i ngjashëm i këtij akti në kopjen e inventarit të administruar në Kolegj, nuk provon se bëhet fjalë për të njëjtin akt me të njëjtën përmbajtje, e për rrjedhojë subjekti i rivlerësimit/kërkuesja Entela Prifti është njohur me të më parë në Komision, si dhe trupi gjykues i Kolegjit është njohur më të para marrjes së vendimit.
Për më tepër, nga përmbajtja e aktit kam vlerësuar se ai ka cilësitë e një dokumenti të përgatitur gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, por që duket se nuk i është njoftuar asnjeherë kërkueses, përndryshe analiza dhe konkluzionet e evidentuara në të, do të kishin gjetur të paktën reflektim në qëndrimet e saj gjatë hetimit administrativ, të pasqyruara në vendimin e Komisionit dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Në analizë të dokumentacionit të administruar me të cilin u realizua gjykimi i kësaj kërkese, dhe argumenteve si më sipër referuar, kam vlerësuar se përsa kohë që nuk provohet ekzistenca e këtij akti, me këtë përmbajtje, në dosjen e Komisionit që është njohur kërkuesja gjatë procesit të rivlerësimit, e në bazë të të cilës është kontrolluar vendimi i Komisionit në Kolegj, ai

[18] *Kjo e dhënë është nxjerr nga dosja e akteve procedurale të administruara në Kolegj.*

përmbush cilësitë për t'u konsideruar provë e re sipas nenit 494, germa "a" të Kodit të Procedurës Civile.

13. Sa i përket rëndësisë së kësaj prove në çështjen që ka qenë objekt kontrolli në Kolegj, pra nëse marrja e kësaj prove do të sillte një vendimmarrje të ndryshme të tij, po paraqes në vijim në mënyrë të përmbledhur vlerësimin tim.
Procesi i rivlerësimit i kërkueses Entela Prifti është përmbyllur bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Kolegji ka konkluduar që subjekti i rivlerësimit/kërkuesja ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr.84/2016, pasi gjendej në kushtet e nenit 33, pika 5, germat "b", "c"dhe "ç" të këtij ligji. Siç edhe referova më sipër, analiza, arsyetimi dhe konkluzionet e Kolegjit që subjekti i rivlerësimit/kërkuesja ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk kanë evidentuar në vendim një analizë financiare apo vlera konkrete të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për pasuritë objekt verfikimi. Për më tepër, duket se në vendimin e Kolegjit ka pasur një vlerësim të ndryshëm lidhur me burimet dhe ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vite, nga analiza ekonomike-financiare e Komisionit e paraqitur si provë e re me kërkesën për rishikim. Kontrolli i vendimit të Komisionit nga Kolegji, mbi një analizë të re ekonomike-financiare, me vlerësime të ndryshme për burimet dhe të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në periudhën 2003-2016, në të cilën konkludohet për një mungesë burimesh financiare të ligjshme në një vlerë prej rreth -820,000 lekë[19], do të passillte një vlerësim të ndryshëm në Kolegj. Gjithashtu, në kushtet kur, konkluzionet e kualifikuara sipas nenit 33, pika 5, germat "c" dhe "ç" të ligjit nr.84/2016, janë bazuar në një vlerësim sipas bindjes së brendshme të trupit gjykues së Kolegjit, të akteve të administruara në dosje, deklarimeve në deklaratat e interesave periodike pasurore si dhe deklarimet e shpjegimet e subjektit/kërkueses gjatë procesit të rivlerësimit, kam çmuar që vlerësimi i tyre mund të ishte jo domosdoshmërisht i njëjtë nga një trup tjetër gjykues i Kolegjit që mund të shqyrtonte këtë kërkesë për rishikim.

14. Në përfundim, bazuar në nenin 498, pika 1 dhe nenin 494, germa "a" të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në sa kam arsyetuar e konkluduar më sipër, kam çmuar se kërkesa e znj. Entela Prifti nuk ishte në kushtet e mospranueshmërisë, pra, ajo duhej të pranohej. Sa i takon mënyrës së shqyrtimit të kësaj kërkese nga Kolegji, pasi ai të merrte vendim për pranimin e saj[20], në konsideratë edhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese[21] dhe Gjykatës së Lartë[22], me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, Kolegji do të duhej të vijonte shqyrtimin e saj në seancë publike për t'i dhënë të drejtës kërkueses të dëgjohej lidhur me themelin e saj.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

---

[19] Vlerë kjo që sipas jurisprudencës së Kolegjit është në kufijtë e aplikimit të parimit të proporcionalitetit.
[20] Sipas nenit 498, pika 1 të Kodit të Procedurës Civile.
[21] Vendimi nr. 4, datë 25.02.2009, vendimi nr. 5/2007, të Gjykatës Kushtetuese.
[22] Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1/2006.